



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Vendimi Nr.27/21
Data: 8 Qershor 2021

Duke u bazuar Nenin 28,29 dhe çështjet procedurale të përcaktuara, sipas Nenit 13,15,17,18,19,20 35,50 dhe Neni 54 par.1.3 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 8 i Plotësim Ndryshimit të Ligjit Nr. 04/L-226, Neni 18 dhe 20 par.1.3 i Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbledhjen e mbajtur me **8 Qershor 2021** mori këtë:

V E N D I M

- I. **LEJOHET**, Përqendrimi përmes blerjes të 100% të asetëve, nga IPKO Telecommunication L.L.C (blerësi) mbi Trio Net O.P., (shitësi).
- II. **IPKO Telecommunications L.L.C**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, më Nr. të biznesit 70064420 dhe më Nr. identifikues 810485301, më adresë në lagjen Ulpiana, Rruga Zija Shemsiu, Nr. 34,10000, Prishtinë. Këto të dhëna janë të paraqitura në çertifikatën e biznesit dhe informatat e biznesit të IPKO-së, aktivitetet e biznesit të IPKO Telecommunications L.L.C, janë të regjistruara pranë Agjencia e Regjistrimit të Biznesit në Kosovë (ARBK), me aktivitetet e telekomunikimit kabllor;
 - a. Tregtia më pakicë e pajisjeve elektro-shtëpiake, në dyqane të specializuara; Hulumtimi i tregut dhe matja e opinionit publik (sondazhet); Kërkime dhe zhvillimi të tjera eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinieri; Kërkime dhe zhvillime eksperimentale në shkencat shoqërore dhe humane; instalime të tjera ndërtimore; Tregtia më shumicë e pajisjeve elektro-shtëpiake; Tregtia me shumicë jo e specializuar dhe Tregtia më pakicë e mallrave të tjera të reja, në dyqane të specializuara.
- III. **Trio Net O.P** - është Ortakëri e Përgjithshme, e themeluar në Kosovë, me Nr. regjistrimi të biznesit 71057186 dhe Nr. unik identifikues 811143156, më adresë të regjistruar në Rogovë, Komuna e Gjakovës, këto të dhëna janë të paraqitura në çertifikatën e biznesit dhe informatat e biznesit të **Trio Net. O.P**, Aktivitetet biznesore të Trio Net O.P (shitësi) të regjistruara pranë, Agjencia e Regjistrimit të Biznesit në Kosovë (ARBK), si në vijim: Aktivitetet e telekomunikimit kabllor, Tregtia më pakicë e mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara, Instalime të tjera ndërtimore, Tregtia më shumicë jo e specializuar.

- IV. Parashtruesi i Njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksë administrative prej 100.00 €. me shkronja (njëqind Euro) dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me Nenin 20 të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtën e Konkurrencës, dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3.000.00 € me shkronja (tre mijë Euro).
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ARSYETIM

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (tutje ref. "Autoriteti"), me datë 15.04.2021, ka pranuar "Kërkesë për Përqendrim", më Nr.Prot:145/21-01/H, nga Blinera Osmani-Bislimi (sipas Autorizimit), me adresë, Rr. Zija Shemsiu, Nr.34.10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me autorizim të palëve në përqendrim, si në vijim, **IPKO Telecommunications L.L.C** dhe/mbi, **Trio Net O.P**, përmes Marrëveshjes së lidhur, më datë 03.03.2021 .

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i dosjes së Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 14.05.2021.
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në ueb faqen e AKK-së, me datë 12.05.2021,
4. Vlerësimi dhe analizimi i çështjeve të konkurrencës në transaksionin e propozuar

Andaj, nga sa më sipër ("Dispozitiv") Autoriteti ka bërë vlerësimin e Kërkesës lidhur me "Marrëveshjen për Transferimin e Përdoruesve të Fundit, të datës. 03.03.2021" për Përqendrim.

Baza Ligjore dhe Akti i Përqendrimit dhe Struktura e Transaksionit

- Duke u bazuar në nenin 15, të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a). Qarkullimi i kombinuar i palëve në Përqendrim e kalon shumë më 3 milion euro, në tregun e brendshëm
- b). Palët në Përqendrim janë të regjistruar në Republikën e Kosovës
- c). Më, datë 03.03.2021, palët kanë nënshkruar Kontratën/ Marrëveshjen për Shit-Blerjen e Aseteve si dhe "Marrëveshjen për Transferimin e Përdoruesve të Fundit për Shërbimet e internetit dhe Televizionit Digjital".

Vlerësimi i Konkurrencës

Tregu Relevant:

- Tregu i gjeografik në transaksionin e propozuar, është komuna e Gjakovës, respektivisht territori i Republikës së Kosovës
- Produkti relevant, është ofrimi i Shërbimit të internetit dhe Televizionit digjital

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni si në "Marrëveshje"

Transaksioni i propozuar do të realizohet, në tregun gjeografik të komunës së Gjakovës, respektivisht territorin e Republikës së Kosovës dhe palët në Përqendrim janë ndërmarrje, që janë të regjistruara dhe veprojnë vetëm në tregun e Republikës së Kosovës. Sipas të dhënave të fundit të strukturës së tregut, IPKO Telecommunication L.L.C, (sipas të hyrave) mbanë pozitë dominuese, prej 27% pjesëmarrje në treg, ndërsa (sipas përdoruesve) 26.71% të tregut.

Duke pasur parasysh se, blerësi përballlet me konkurrencë reale dhe si rrjedhojë, ka sjellë tregun përkatës në përqendrim të ulët për arsye se i njëjti, del se është shumë konkurrues duke marrë parasysh edhe konvergjencën e shërbimeve nga ndërmarrjet që i ofrojnë këto, gjithashtu edhe qarkullimi i "targetit" është në vlera të papërfillshme, veprimtaria e të cilit shtrihet, vetëm në një komunë (Gjakovë) dhe numri i përdoruesve të fundit është modest, përkitazi me këtë vlerësojmë se, ky transaksion nuk paraqet efekte negative në konkurrencë për arsye se i njëjti nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes "blerëse" tek konkurrentët apo konsumatorët fundor, por që ndërmarrjet me dominancë në treg, duhet të jenë të kujdesshme në këto situata, sepse nënkupton, që në treg do ketë një konkurrent më pak.

Vëmendje:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës respektivisht sjellje anti-konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.


Me këtë Vendim të njoftohen:


- Palët
- Arkiva

AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS KOMISIONI


Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar


Fatime Haziri
Anëtare


Muhamed Krasniqi
Anëtar


Shaqir Morina
Anëtar

